



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 02 maj 2017, në mbledhjen e XXXIX - të (tridhjetenëntë) të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 13.05’.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht Kryesues i këtij Komiteti.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti: Bahri Blakçori, Islam Revuçi, Fidan Rekaliu, Haki Rudari, Kadri Avdiu, Kumrie Hoti, Mynavere Abdullahau – Krasniqi, Naim Çunaku dhe Rafet Llapashtica.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe Isuf Latifi, drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave (DBF), Florije Besholli, drejtoreshë e Drejtorisë së Inspeksionit (DI), Abaz Llugaliu, drejtor i Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë (DPKGJ), Muharrem Haziri, OSBE dhe përfaqësues të KFOR-it.

1. Miratimi i rendit të ditës

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, e hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit, dhe shtoi, konsideroj se rendi i propozuar i ditës dhe materiali përkatës për këtë mbledhje ju është dërguar me kohë, andaj para se të hedhet në votim, a dëshiron ndokush ta merr fjalën.

z.Abaz Llugaliu, drejtor i DPKGJ, theksoi, kemi një kërkesë për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS, me qëllim të ndërtimit të një trafostacioni në fshatin Dyz, kërkesë e cila është bërë po nga kjo kompani më 18.04.2017 përmes zyrës pritëse, por që është kërkesë edhe e banorëve të atij fshati, kështu që pak sa ka qenë vonë që kjo kërkesë të procedohej së bashku me materialin për këtë mbledhje, andaj nëse ju anëtarët e KPF-së e shihni të arsyeshme ta futni në kuadër të rendit të ditës dhe t’i rekomandoni Kuvendit për shqyrtim mendoj se do të ishte në interes të banorëve të atij fshati. Në vazhdim ju shpërndahet kërkesa në fjalë të gjithë të pranishmëve.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, pra kemi një kërkesë për përfshirje në rendin e propozuar të ditës për këtë mbledhje, andaj nëse ndokush nga anëtarët e KPF-së keni diçka për shtuar, urdhëroni, nëse jo, e hedh në votim.

Pas votimi u konstatua se me 9 vota për, asnjë votë kundër, një votë të përmbajtur u miratua propozimi për përfshirje të kërkesës së KEDS në rend dite.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, tani e hedh në votim rendin e propozuar të ditës duke përfshirë edhe pikën shtesë të miratuar paraprakisht.

Pas votimi u konstatua se me 9 vota për, asnjë votë kundër, një votë të përmbajtur u miratua rendi i propozuar i ditës duke përfshirë edhe;

- *Kërkesën për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS. (në pikën 7 të rendit të ditës)*

2. Ekstraktet e Procesverbaleve nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtura më 06 mars 2017 dhe 30 mars 2017

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kemi dy Ekstrakte të procesverbaleve nga mbledhjet paraprake, dhe nëse nuk i keni vërejtur që në të dyja këto është lëshuar një gabim teknik, përkatësisht në fund është shkruar viti 2018 e që do të duhej të ishte 2017, andaj kërkoj që kjo të korrigohet, por nëse kanë diçka tjetër anëtarët tjerë të KPF-së mund ta paraqesin, nëse jo i hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se njëzëri u miratuan Ekstraktet e procesverbaleve nga mbledhjet e Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më 06 mars 2017 dhe 30 mars 2017, duke përfshirë edhe kërkesën e Kryesuesit të Kuvendit për korrigjimin e gabimit teknik.

3. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës, për periudhën janar – mars 2017

z.Isuf Latifi, drejtor i DBF, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, është një raport tremujor në të cilin janë përshkruar të gjitha shpenzimet dhe të hyrat sipas kodeve dhe kategorive ekonomike të paraqitura në tabela përkatëse që janë bërë gjatë kësaj periudhe. Si karakteristikë mund të themi se është një rënie e shpenzimeve në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit 2016, ndërsa tek të hyrat kemi një rritje, mirëpo është një periudhë e shkurtër dhe në fakt buxheti ka filluar të ndahet në pjesën e dytë të muajit shkurt. Pra të gjitha të hyrat dhe shpenzimet gjatë kësaj periudhe janë paraqitur në këtë raport financiar.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e vlerësojmë punën e mirë që është duke e bërë drejtori i DBF në vazhdimësi sa i përket zbatimit të ligjit rreth raportimeve financiare sepse jemi në dijeni se sjellja e raporteve periodike në Kuvendin e Komunës është e obligueshme edhe me ligj, mirëpo më e rëndësishmja është pasqyrimi në detaje i çdo të hyre dhe çdo shpenzimi të Komunës gjatë periudhave kohore përkatëse duke përfshirë edhe këtë tremujor të vitit 2017. Pra rreth këtij raporti ne do të diskutojmë edhe nesër në mbledhjen e Kuvendit të Komunës, por e përsërisë se e vlerësojmë punën e mirë që është duke e bërë drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve nga radhët e PDK-së nuk kam diçka për të thënë në këtë mbledhje rreth këtij raporti, andaj e përkrahim që ky raport t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të mëtutjeshëm, mbledhje në të cilën sigurisht që do të debatojmë dhe do t'i japim mendimet tona sa i përket raportit financiar.

z.Haki Rudari, theksoi, unë mendoj se ana pozitive është vet përfshirja e këtij raporti në rend të ditës përkatësisht njoftimi i këshilltarëve të Kuvendit që në një mënyrë është përmbushur obligimi ligjor, mirëpo nëse hymë dhe analizojmë këtë raport mendoj se është shumë shqetësues, të paktën kështu mendojmë ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së, për arsye se në këtë periudhë tremujore në shumën e paraparë për investime kapitale prej 5,472,479.00 €, janë investuar vetëm 200,033.00 €. Pra mendoj se është tejet shqetësuese kur kemi parasysh që qytetarët kanë nevojë për investime të shumta kudo në të gjitha komunitetet, lagjet, fshatrat dhe në çdo sektor Komuna jonë dhe banorët e saj kanë nevoja të shumta për investime qoftë në bujqësi, arsim, mbrojtje të ambientit, lumenjve etj, gjë të cilën e kam përsëritë disa herë, pra shtrohet pyetja, përse ndodh që për tre muaj të shpenzohet shumë aq e vogël. Një aspekt që e kam vërejtur si gjë pozitive është rritja e të hyrave vetanake prej 3.72% në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, andaj mendoj se edhe ky është një element pozitiv sepse sa më shumë të ketë inkasime të të hyrave sërish ato mjete do t'ju kthehen qytetarëve përmes investimeve. Nuk kam tjetër të shtoj në këtë mbledhje por diçka më shumë do të debatojmë në mbledhjen e nesërme të Kuvendit të Komunës.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, meqë nuk ka anëtarë tjerë të lajmëruar për diskutim, në fund dëshiroj t'i them edhe unë disa fjalë rreth kësaj pike. Falënderoj Drejtorinë e Buxhetit dhe Financave e cila në vazhdimësi është duke i respektuar afatet ligjore përkatësisht sjelljen e raporteve financiare periodike. Materiali është ky që është dhe përmban shënime zyrtare të cilat merren nga Departamenti i Thesarit por edhe nga sistemet tjera buxhetore. Sa i përket të hyrave vetanake konsideroj se duhet të kemi kujdes që ato t'i rritim sa më shumë të jetë e mundur, dhe atë jo vetëm nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave por edhe nga Drejtoritë tjera në mënyrë që planifikimet tona si Komunë të arrihen në mënyrë të kënaqshme. Sa i përket asaj që parafolësi z.Haki Rudari e tha në lidhje me shumën e shpenzuar, unë nga përvoja e them se në tremujorin e parë të vitit nuk mund të bëhen shpenzime të mëdha sepse janë procedurat e prokurimit ato të cilat e pamundësojnë një gjë të tillë, pastaj është periudha deri sa të nënshkruhen kontratat, ekzekutimi i punimeve, pranimiti i punëve dhe tek në fund bëhen pagesat, prandaj në tremujorin e parë rrallëherë ndodh që mund të kryhet ndonjë punë, mirëpo çdo sugjerim i dhënë nga ana e secilit prej nesh do të ishte në interes të Komunës në përgjithësi për arritjen e sukseseve. Edhe njëherë e përsërisë që do të ishte mirë të japim kontributet tona gjithsecili prej nesh për rritjen e inkasimit të të hyrave vetanake.

Pas votimit u konstatua se raporti financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – mars 2017, njëzëri i rekomandohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

4. Propozimi i Planit të veprimit për transparencë në Komunën e Podujevës për vitin 2017

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sigurisht jeni në dijeni se ne si Komunë kemi të miratuar Rregulloren përkatëse për transparencë e cila është e bazuar në ligjin për përkatës për transparencë, mirëpo Komunitat për çdo vit janë të obliguara ta miratojnë edhe Planin e veprimit për transparencë, plan i cili rrjedh prej legjislacionit përkatës në fuqi, do të thotë se të gjitha këto që janë paraparë në këtë draft plan janë të bazuara në akte të ndryshme ligjore dhe nënligjore që kanë të bëjnë me transparencën në Komunë, si dhe janë të përfshira edhe detyrat dhe përgjegjësitë e Ekzekutivit të Komunës dhe shërbimeve tjera për zbatimin e këtij plani. Sigurisht e keni lexuar dhe analizuar këtë plan, andaj fjala është për ju.

z.Fidan Rekaliu, theksoi, ne Grupi i këshilltarëve nga radhët e LDK-së e përkrahim këtë Plan dhe konsiderojmë se është mjaft i rëndësishëm në aspektin e rritjes sa më të madhe të transparencës në Komunën e Podujevës karshi qytetarëve të interesuar për mënyrën e funksionimit të Komunës si institucion, andaj për këto dhe arsye tjera ne e përkrahim këtë plan të veprimit për transparencë në Komunën e Podujevës.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, kushdo që keni propozime, sugjerime apo vërejtje eventuale mund t'i paraqitni. Gjithashtu dëshiroj t'ju njoftoj se zbatimi i planeve të tilla vlerësohet për çdo vit nga niveli qendrorë por edhe nga shoqëria civile se sa kanë përmbushur Komunitat veç e veç objektivat dhe obligimet ligjore që kanë të bëjnë me transparencën. Mund të them se ndoshta jemi paksa të vonuar rreth kësaj çështje sepse ky propozim plan është dashur të sjellët në muajin shkurt, por si do që të jetë konsideroj se ende nuk jemi vonë.

z.Haki Rudari, theksoi, konsideroj se në parim është mirë miratimi i një plani të veprimit për transparencë në Komunën e Podujevës, por ajo që kam vërejtje e që vazhdimisht e kam përcjellë ka të bëjë me lëshuarjen e komunikatave që bëhen nga Zyra për informim e Komunës së Podujevës dhe në këtë drejtim kam vërejtje të cilat më në detaje do të jap nesër në mbledhjen e Kuvendit, mirëpo, komunikatat po janë shumë të njëanshme, nuk ka shumë takime apo njoftime për gazetarë kur po thirren mbledhjet nga organet e ndryshme komunale, dhe po ashtu qytetarët po janë shumë pak të njoftuar për takimet që mbahen me qytetarë, vërejtje e cila më takon edhe mua personalisht dhe që e kam pranuar pjesën time që më takon, pra rreth kësaj në një mënyrë mund të shtrojmë pyetje, a është frika për vërejtje të qytetarëve për projekte të ndryshme, apo çka është, mbetet përgjigje e Ekzekutivit të Komunës, për më tepër do të diskutojmë nesër në mbledhjen e Kuvendit por i ceka këto çështje që për mua janë paksa më shqetësuese sepse transparenca duhet të jetë transparencë për të gjitha subjektet politike, pastaj të gjitha komunikatat që lëshohen duhet t'iu lihen hapësirë dhe se secili subjekt politikë që e thotë të vetën duhet të përfshihen ato vërejtje apo propozime, mirëpo unë kam përcjellë të gjitha komunikatat që lëshohen nga Zyra për informim, qoftë pas seancave të Kuvendit, qoftë pas debateve me qytetarë dhe të tjera, andaj në këtë drejtim kam vërejtje por që më detajisht do t'i paraqesë nesër në Kuvend.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, për çdo vërejtje e cila konsiderohet e qëlluar, ne nuk kemi asgjë kundër, mirëpo jam në dijeni dhe vazhdimisht i përcjellë edhe unë, sidomos sa i përket mbledhjeve të Kuvendit të Komunës dhe trupave të tij, lajmërimet gjithëherë bëhen me kohë në tabelën e shpalljeve, po ashtu në ueb faqen zyrtare, mandej publikimi i akteve të ndryshme të Kuvendi bëhet me kohë pas përfundimit të proceduarave përkatëse ligjore si dhe çështje tjera të nevojshme. Nëse nuk anëtarë tjerë të lajmëruar për diskutim, e hedh në votim këtë propozim.

Pas votimi u konstatua se propozimi i planit të veprimit për transparencë në Komunën e Podujevës për vitin 2017, njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

5. Propozimi i vendimit për miratim paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kemi të bëjmë me dhënien në shfrytëzim afatshkurtër, mirëpo për dhënie në shfrytëzim afatgjatë sipas një shkresë të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal që na është sjellë para disa ditësh përveç tjerash thuhet se Kuvendet e Komunave të Kosovës kanë afat vetëm deri më 15 maj

2017 që të marrin vendime për dhënie në shfrytëzim afatgjatë të pronave komunale. pra vetëm desha t'ju njoftoj për këtë, ndërsa rreth kësaj pike fjalën hyrëse do ta paraqet drejtori i DPKGJ.

z.Abaz Llughaliu, drejtor i DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse, ndër të tjera theksoi, sa i përket këtij propozim vendimi bëhet fjalë për një parcelë në fshatin Lupç i Poshtëm përkatësisht Bugurdoll siç njihet nga e kaluara, parcelë e cila mund të them se për momentin është shndërruar në deponi të egër të mbeturinave. Pra ka të interesuar për të marrë në shfrytëzim atë parcelë e cila është tokë bujqësore dhe jepet për qëllime bujqësore, mirëpo propozimin sigurisht e keni lexuar dhe keni vërejtur se bëhet fjalë për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër sipas ligjit përkatës për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim. Vlen të përmendet se përveç që krijohen të ardhura për Komunën dhe hapjes së vendeve të punës është pozitive edhe për mbrojtjen e natyrës dhe ambientit në përgjithësi sepse mund të keni informata edhe ju se në atë hapësirë hedhen mbeturina të ndryshme duke përfshirë edhe mbetje shtazore, dhe vazhdimisht nga banorët përreth ka pas edhe ankesa lidhur me këtë.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, sa i përket këtij propozim vendimi, konsideroj se procedurat janë të qarta, ne si Kuvend marrim vendim ndërsa procedurat tjera i zhvillon komisioni përkatës i ngritur nga Kuvendi i Komunës.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, konsideroj se inkasimi i të hyrave nga shfrytëzimi i pronave komunale sidomos në vendet rurale është shumë i nevojshëm sepse në të kundërtën ato prona vetëm rrinë ashtu siç janë por ka edhe të atilla që degradohen dhe që degradojnë ambientin. Në këtë aspekt mendoj se Ekzekutivi i Komunës ose Kuvendi i Komunës do të ishte mirë të merrte një vendim me të cilin do të rregullohen starti minimal i ofertës, do të thotë që është mirë të caktohet një çmim fillestar në mënyrë që pastaj ofertuesit të bazohen në atë çmim, ndërsa përfituesi dihet se është ai i cili oferton me çmimin më të lartë. Pra unë e mbështes këtë propozim vendim sepse ajo pronë nuk është e shfrytëzueshme me vite të tëra, ndërsa me dhënien në shfrytëzim sigurisht se mbrohet ambienti, krijohen të hyra për Komunën dhe për investitorin. Mbetet që ky propozim t'i rekomandohet Kuvendit dhe nëse miratohet atëherë është obligim i komisionit përkatës dhe zyrtarëve tjerë që të përcaktojnë kushtet dhe çmimin fillestar për të cilin do të kërkoja të jetë i arsyeshëm për të dy palët.

z.Naim Çunaku, theksoi, kur kemi të bëjmë me dhënien e pronave komunale në shfrytëzim, unë edhe kohë më parë por edhe tani në vazhdimësi kam shpreh gatishmëri për një gjë të tillë, mirëpo apeloj tek organet e Ekzekutivit të Komunës që të gjitha pronat komunale të cilat mund të jepen në shfrytëzim, mos të rrinë në formën e fjetur siç është duke ndodhur, në mënyrë që ato të mos atakohen nga keqpërdoruesit, për të mos thënë uzurpatorët. Dëgjova që u tha se ka pas interesim për marrjen e pronave në shfrytëzim, mirëpo mendoj se ai interesim ka qenë pasi ne si Kuvend kemi marrë vendime përkatëse për prona përkatëse, pra vetëm atëherë të interesuarit mund t'i shfaqin interesimet e tyre, sepse kjo procedurë është e rregulluar me dispozita përkatëse ligjore. Pra kanë mund ta kenë një lloj hulumtimi për atë pronë sepse shprehja e interesit bëhet nga Komisioni përkatës. Sa i përket asaj që u përmend nga Kryesuesi i Kuvendit se për çfarë periudhe kohore do të jepet në shfrytëzim kjo pronë, konsideroj se kjo çështje është e përcaktuar qartë me ligjin për vetëqeverisje lokale dhe ligji për dhënien e pronave komunale në shfrytëzim dhe këmbimin e tyre, kështu që nuk e shohë këtë si problem sepse atë njoftim Ministria e ka bërë për ata që nuk i lexojnë ligjet fare. Për fund unë edhe një herë po e shfaq mendimin tim dhe po kërkoj që në një periudhë sa më të shkurtër kohore, të gjithat pronat komunale që mund të jepen në shfrytëzim, duhet të jepen por është mirë të paktën ta dimë adresën ku është ajo pronë dhe çfarë kërkojmë prej saj, dhe me këtë arrijmë disa qëllime, dhe atë 1-ne si Komunë e ruajmë pronën komunale, e identifikojmë

dhe kemi adresë se ku gjendet, 2-krijojmë të hyra vetanake për Komunën të cilat janë shumë të nevojshme për investime, dhe 3-ju japim njerëzve mundësi që të punojnë, të zhvillojnë biznese për familjet e tyre dhe për vete.

z.Haki Rudari, theksoi, unë e kam këtu përpara ligjin nr.04/L-144 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, në nenin 4 parashihen parimet e dhënies së pronës së paluajtshme komunale në shfrytëzim, dhe unë po i lexoj vetëm 2 prej tyre të cilat mendoj se është mirë të debatohen, -parimi i transparencës, dhe -parimi i ruajtjes dhe vlerës së pronës komunale, pra edhe nga kolegu më përpara u tha se është mirë që mos të jepet vetëm me një çmim ashtu, por t'i rritet vlera e asaj prone komunale. Gjithashtu neni 1.3 parasheh parimin e ruajtjes së mjedisit, dhe tani meqë prezent këtu është edhe drejtoresha e Drejtorisë së Inspeksionit, unë dëshiroj që këtë ta ndërlidhë me një ankesë të madhe nga banorët e fshatit Gllmanik lidhur me problemin që kanë me një thertore në atë mjedis, andaj mendoj se në këtë drejtim është mirë që të kemi shumë kujdesë sa i përket parimit për ruajtjen e mjedisit për arsye se nuk është mirë t'i jepet një personi edhe pse ndoshta punëson një numër të të punëtorëve por në të njëjtën kohë ndoshta mund të kenë probleme shumë qytetarë ose lagje nga ai ndërtim, siç është rasti i lartcekur ku sipas banorëve të atij fshati janë bërë ankesa të vazhdueshme, madje edhe në Ministrinë përkatëse rreth atij problemi si pasojë e erërave që krijohen sidomos gjatë verës kur është nxehtë. Prandaj mendoj se është parim për ruajtjen e mjedisit paraparë në ligjin përkatës dhe si i tillë duhet marrë për bazë.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, ajo që u tha nga parafolësi mendoj se janë parime të përgjithshme, mirëpo në rastin konkret kemi të bëjmë me tokë bujqësore, ndërsa sa i përket asaj që e ceku z.Rafet Llapashtica rreth çmimit fillestar, mendoj se është mirë të caktohet një çmim fillestar i arsyeshëm.

z.Abaz Llugaliu, drejtor i DPKGJ, theksoi, sa i përket caktimit të çmimit fillestar, ne kemi hulumtuar dhe kemi parë se të gjitha Komunitatet e Kosovës po japin prona komunale në shfrytëzim dhe në këtë aspekt kemi analizuar çështje të ndryshme që ndërlidhen me këtë. Nëse marrim si pikë nisëse dhe caktojmë çmimin me m² siç kemi vepruar në fshatin Sallabaj me 0.05 € m², ndërsa në qoftë se kemi të bëjmë me hektarë atëherë kalohet ajo mesatarja që janë dhënë përpara nga ana e kooperativave 50 € ose 100 €, pra mund të kalohet ai pragu më i ultë por mund që ndokush të merr edhe ndoshta me 0.50 € m².

Sa i përket kërkesës së z.Naim Çunakut për dhënien e të gjitha pronave komunale në shfrytëzim, mund të them se tek ne si Ekzekutiv i Komunës paraqiten qytetarët me kërkesa, madje edhe me projekte ideore për vende – prona të caktuara dhe në këtë aspekt pastaj ka raste që paraqiten probleme, shembull konkret kemi fshatin Herticë ku është një parcelë - bjeshkë të njohura si ara të kooperativës rreth 16 hektarë për të cilën disa persona kanë sjellë projektin ideorë nga i cili mund të krijohen vende të reja të punës dhe të mira tjera, mirëpo paraqitet problemi ku banorët e asaj ana thonë se nuk e lejojnë një gjë të tillë me arsyetim se është i vetmi burim ku i kullohim bagëtitë etj, dhe në këtë aspekt ne nuk jemi për ngatërresa eventuale mes qytetarëve, andaj po na duhet të kërkojmë edhe pëlqimin e banorëve të mjedisëve përkatës dhe përfaqësuesve të fshatit gjë të cilën në rastin e këtij propozim vendimi e kemi arrit, kurse sa i përket përfituesve të pronave komunale për marrje në shfrytëzim këtë e përcakton konkurrenca në bazë të ofertave, kështu që për këtë arsye mendoj se nuk është e rrugës të merret vendim për dhënie në shfrytëzim të të gjitha pronave komunale të destinuara për dhënie në shfrytëzim.

z.Kadri Avdiu, theksoi, më bëri përshtypje drejtori parafolës kur e tregoj rastin për fshatin Herticë që banorët e atij fshati nuk japin pëlqim për një pronë e cila është pronë e Komunës,

mendoj se nuk duhet të kërkohet pëlqim nga banorët për dhënie në shfrytëzim të një prone për qëllime bujqësore kur kemi parasysh se prona përkatëse është në pronësi të Komunës, ndërsa në anën tjetër ata banorë ta shfrytëzojnë atë pronë siç ishte rasti i lartcekur e që ka edhe shumë raste të cilat shfrytëzohen me garazhe, shtëpi dhe objekte ose qëllime tjera nga persona të ndryshëm dhe që ne nuk jemi në dijeni se ajo pronë është në pronësi komunale. Konsideroj se në qoftë se njerëzit janë të interesuar të punojnë në fusha të ndryshme, është mirë që të gjitha pronat komunale të jepen në shfrytëzim në mënyrë që t'ju japim mundësi të gjitha atyre të interesuarve për vetëpunësim dhe punësim të tjerëve gjë e cila do të ishte në interes jo vetëm të Komunës nga krijimi i të hyrave, por në interes të të gjithë qytetarëve. Mendoj se ka kaluar koha e shfrytëzimeve të pronave komunale nga persona të ndryshëm pa leje ose vendim të organeve komunale, shembull për këtë e marr fshatin ku unë jetoj ku në bazë të dokumenteve janë rreth 30 hektarë pronë komunale kurse përveç varrezave dhe pjesa e shkollës që ekziston e tërë pjesa tjetër është e shfrytëzueshme prej individëve të ndryshëm, pastaj ka raste ku rrugët që kanë ekzistuar ndoshta me 500 vite janë mbyll dhe janë lëvruar, andaj në këtë aspekt duhet të kemi kujdes sepse Ekzekutivi i Komunës dhe shteti në përgjithësi për çështje të tilla duhet të ndërmarrin veprime konkrete sepse për këtë edhe janë, dhe duhet të kenë qasje më serioze sepse nuk ka nevojë të merren pëlqime prej banorëve për prona të cilat janë pronë publike komunale për teke të ndryshme të individëve të ndryshëm, ta zëmë një individ ka nxënë një pronë ose ka ndërtuar në ndonjë pronë komunale dhe tani nuk e lëshon atë dhe nuk i përgjigjet askujt qoftë me pagesa qoftë me dokumentacion, andaj në raste të tilla duhet ose të paguhet qiraja ose të lirohet ajo pronë sepse kemi të bëjmë me pronë publike e jo personale.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk kam qëllim për polemizim me askënd por atë që e thash sinqerisht e mendoj se duhet të jetë ashtu dhe arsyeja pse po e them këtë është, po ta kishim në ueb-faqen zyrtare të komunës numrin e pronave komunale që janë të lira dhe të mundshme për tu shfrytëzuar duke përfshirë edhe të dhëna tjera për ato prona, atëherë do të mund të shfaqnin interes qytetarët kur vërtetë shohin se çka mund të marrin në shfrytëzim. Ashtu siç e potencoj edhe parafolësi, ne jemi në dijeni dhe secili prej nesh mund të nisemi nga lagjet tona, ato prona sot tek ne nuk ekzistojnë sepse janë duke u shfrytëzuar në mënyrë shumë të egër do të thoja dhe pa kurrfarë kompensimi, ndërsa sa përket asaj që u cek si shembull për kullosat, unë absolut nuk jam që ndokujt t'i ngushtohet diçka, por nëse dikush i shfrytëzon rreth 5 ose 20 hektar për kullosa duhet ditur se duhet të paguaj për atë shfrytëzim, mirëpo nëse ne i tolerojmë në këtë formë, ata persona në të ardhmen pas rreth 20 viteve, nëse nuk jam gabim, në procedurë civile, do ta kontestojnë edhe pronësinë mbi ato prona.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, konsideroj se diskutimet u kryen rreth kësaj pike të rendit të ditës, qëllimi i këtij diskutimi ishte pozitiv dhe mund të marrim mësim nga vërejtjet që u dhanë dhe në të ardhmen të shikojmë se çka mund të bëjmë në këtë drejtim. Unë edhe njëherë ja rikujtoj juve e në veçanti drejtorit të DPKGJ z.Abaz Llugaliut që deri më 15 maj 2017 është afati i fundit që mund të marrim vendime për dhënie të pronave komunal në shfrytëzim afatgjatë, kështu që nëse keni ndërmend ta procedoni ndonjë propozim të tillë duhet të në afat sa më të shkurtër dhe atë madje vetëm me ndonjë mbledhje urgjente. Nëse nuk keni diçka tjetër unë e hedh në votim këtë propozim vendim sipas materialit të dërguar.

Pas votimit u konstatua se propozimi i vendimit për miratim paraprak për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës në fshatin Lupç i Poshtëm, njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

6. Korrigjimi i gabimit teknik në Vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore nr.01-320-32374, datë 10 prill 2014

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, në mbledhjen e kaluar të Kuvendit të Komunës, unë ndoshta gabova që në pikën të ndryshme e prezantova këtë çështje, mirëpo e konsiderova se kemi të bëjmë me një gabim teknik, por si do që të jetë sërish vendosëm që ta procedojmë së bashku me rendin e propozuar të ditës. Fjala është për një gabim teknik përkatësisht në nenin 1 të Vendimit është shkruar gabimisht numri i ngastrës kadastrale 746-3 e që është dashur të jetë 764-3, gabim i cili është vërejtur pasi që pronari i parcelës ka kërkuar regjistrimin e asaj prone në Zyrën e kadastrit, e që nuk ka mundur sepse në vendim ka figuruar numri që realisht nuk ekziston fare, pastaj Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit më është drejtuar me kërkesë për korrigjimin e këtij gabimi teknik, andaj unë e kam parë të arsyeshme që ky korrigjim të bëhet përmes Kuvendit dhe konsideroj se çdo gjë është në rregull sa i përket kësaj çështjeje sepse është i njëjti person dhe bëhet fjalë për të njëjtën parcelë, madje edhe me rastin e procedimit dhe miratimit të Vendimit në fjalë, pjesë përbëre e propozimit ka qenë certifikata e pronësisë dhe kopja e planit me numrin real të asaj ngastre. Nëse nuk keni diçka për të shtuar, unë e hedh në votim, a pajtoheni që kjo pikë t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

Pas votimit u konstatua se njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim të korrigjimit të gabimit teknik në Vendimin për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore nr.01-320-32374, datë 10 prill 2014, përkatësisht në nenin 1 të këtij Vendimi, në vend të numrit të ngastrës kadastrale 746-3, të bëhet 764-3.

7. Kërkesa për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i Kuvendit, theksoi, realisht kjo kërkesë u mbështet në fillim të kësaj mbledhjeje që të përfshihet në rend të ditës, mirëpo njëkohësisht për të njëjtën u dhanë edhe arsyetimet e nevojshme. Sigurisht që për mbledhjen e Kuvendit do të përgatitet edhe propozimi i vendimit përkatës, andaj nëse keni diçka për të diskutuar, urdhëroni, nëse jo e hedh në votim.

Pas votimit u konstatua se Kërkesa për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike – KEDS, njëzëri i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Kryesuesi i Kuvendit e konstatoj këtë mbledhje të përfunduar.

Mbledhja përfundoi në orën 13.45'.

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr. 01-060/01-0034268/17

Podujevë,

02 maj 2017

Kryesuesi i Komitetit

Mehmet Gashi